

Njoftim për Shtyp

Zhvillohet mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Ditën e mërkurë, datë 27.09.2023, ora 16.00, pranë zyrave të institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, anëtarët z. Sandër Simoni, z. Maksim Haxhia dhe z. Ilir Dode, ndërkohë që anëtari tjetër z. Shaban Sinani për arsye objektive nuk ishte prezent në mbledhje.

Të pranishëm në mbledhje, me statusin e vëzhguesit, ishin gjithashtu dhe përfaqësues nga misionet ndërkombëtare në Shqipëri, gjegjësisht nga projekti EU4Justice dhe OPDAT.

Në përputhje me rendin e ditës takimi u fokusua në problematikat e hasura deri më tani sa i takon verifikimit të integritetit të kandidatëve, kohëzgjatjes së këtij procesi nga institucionet përgjegjëse si dhe mundësisë së identifikimit të zgjidhjeve përkatëse, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni diskutoi dhe miratoi Rregulloren “Për funksionimin e Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga rradhët e avokatëve”, si dhe u dakortësua që detajimi i mëtejshëm i kriterëve profesionale dhe morale si dhe caktimi i peshës specifike të tyre për renditjen e kandidatëve, do të bëhet me një vendim të veçantë të tij.

Në përfundim, Komisioni vendosi që mbledhja e rradhës të zhvillohet ditën e hënë, datë 02.10.2023, ora 16.00, pranë ambienteve të institucionit të Avokatit të Popullit, ku ndër të tjera do të nisë edhe verifikimi paraprak i plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët.